



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .05.2024

**MBLEDHJA Nr. 14,
Datë 09.05.2024, ora 11:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 09.05.2024, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 14 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të ERE-s më datë 02.04.2024 dhe datë 02.05.2024.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin prill 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “H.K. HEC GRABOVA 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr.62, datë 11.04.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq i Digës Qyrmaq, Hec Vau i Dejës, me kapacitet të instaluar 5.143 MWp.
5. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s 265, datë 20.12.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë “BE-IS ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et: “Kalivar 1, 2, 3, 4”, i ndryshuar.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**